

PKR.nr.422/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues nga tre gjyqtarët profesionistë Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Vehbi Kashtanjeva e Isuf Makolli, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarve: B.I.; L.K.dhe E.D., të akuzuar për shkak të veprave penale Sulmi, në bashkëkryerje, nga neni 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Lëndim i lehtë trupor, në bashkëkryerje, nga neni 188, par. 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.1105/13, të datës 29.07.2015, pas shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 30.10.2018 dhe 30.11.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit **Feti Tunuzliu dhe Bukurie Gjonbalaj**, të akuzuarit L.K.dhe E.D., dhe të dëmtuarit –dëshmitarët: A.S., B.B.dhe F.B., të njëjtën ditë, me datë 30.11.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I.****Të akuzuarit:**

L.K., i biri i B.1 dhe M., e vajzërisë Rr., i lindur me datë ..., në S.1, tani me vendbanim në F.K., rruga “F.i L.”, numër .., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar- pa fëmijë, i punësuar-realizon pagë mujore prej ... euro, i gjendjes së mesme ekonomike, **shqiptar** – shtetas i Republikës së Kosovës dhe

E.D., i biri i F. dhe R., e vajzërisë O., i lindur me datë ..., në fshatin B.2, Komuna S.2, tani me vendbanim në F.K., lagjja “K.”, banesa numër ..., kati i ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i punësuar- realizon pagë mujore prej ... euro-i gjendjes së mesme ekonomike, **shqiptar** – shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

S e p s e: me datë 05.11.2013, rreth orës 18:27, në F.K., në rrugën “N.T.”, gjegjësisht te parku i qytetit, në bashkëveprim, me dashje kanë përdorur forcën ndaj të dëmtuarve A.S. dhe B.B., të cilët i kanë goditur në pjesë të ndryshme të trupit,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Sulmi, në bashkëkryerje, nga neni 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: **41; 46; 73 dhe 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK, si dhe nenit 365 të KPPK**, të akuzuarve L.K.dhe E.D. iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumën prej treqind (300) Euro, secilit veç e veç, të cilin detyrohen ta paguajnë në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata do t'i caktoj një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- Obligohen të akuzuarit që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej tridhjetë (30.00) € dhe pesëdhjetë (50.00) €, për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Të dëmtuarit: A. (T.) S.**, nga fshati M. e P., rr. “Y. i D.”, nr. ...; dhe **B. (F.) B.**, nga fshati M. e P., rr. “Y. i D.”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

II.

Konform nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

Ndaj të akuzuarve:

B.I., i biri i J. dhe M., i lindur me datë ..., në L., tani me vendbanim në F.K., rruga “G.”, pa numër, **shqiptar** – shtetas i Republikës së Kosovës

L.K. i biri i B. dhe M., e vajzërisë Rr., i lindur me datë ..., në S., tani me vendbanim në F.K., rruga “F. i L.”, numër ..., me numër personal ..., **shqiptar** – shtetas i Republikës së Kosovës dhe

E.D., i biri i F. dhe R., e vajzërisë O., i lindur me datë ..., në fshatin B.2, Komuna S.2, tani me vendbanim në F.K., lagjja “K.”, banesa numër ..., kati i p..., me numër personal ..., **shqiptar** – shtetas i Republikës së Kosovës.

REFUZOHET AKUZA

S e p s e: me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë, në bashkëveprim kanë filluar ta godasin të dëmtuarin F.B.n, në pjesë të ndryshme të trupit, pastaj i pandehuri B.I., me qëllim të shkaktimit të lëndimit trupor, duke përdorë mjet të përshtatshëm për shkaktim të lëndimit të rëndë trupor gjegjësisht thikë e ka goditur të dëmtuarin dhe atë një herë në regjionin kërbishtor dhe një herë në regjionin mbi gjurin e djathtë, me ç rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar lëndime trupore të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore,-

- **me çka, kishin për të kryer veprën penale** Lëndim i lehtë trupor, në bashkëkryerje, nga neni 188, par. 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK,
- **pasi që me datë 05.11.2017, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.**
- **Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.**
- **I dëmtuari F. (B.) B.**, nga fshati M. e P., rr. “Y. i D.”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.1105/13, të datës 29.07.2015, e ka akuzuar të pandehurit: B.I.; L.K.dhe E.D., të akuzuar për shkak të veprave penale Sulmi, në bashkëkryerje, nga neni 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Lëndim i lehtë trupor, në bashkëkryerje, nga neni 188, par. 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK, ndërsa i akuzuari B.I., i akuzuar edhe për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 26.07.2018, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se sa i përket veprës penale si në pikën 2 të dispozitivit të aktakuzës, me datë 05.11.2017 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Me aktvendimin e kësaj gjykate PKR.nr.422/15, të datës 30.10.2018, është veçuar procedura penale ndaj të akuzuarit B. (J.) I., i lindur me datë ..., në L., tani me vendbanim në F.K., për veprat penale Sulmi, në bashkëkryerje, nga neni 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK dhe Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 1, të KPRK, për të cilin në gjykatë është paraqitur prindi i tij i cili e ka njoftuar gjykatën se ka më shumë se një muaj që biri i tij B.3, ka dalë jashtë shtetit dhe nuk ka njohuri kur do të kthehet.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 30.10.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit L.K.dhe E.D., kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe janë deklaruar të pa fajshëm për veprën penale Sulmi, në bashkëkryerje, nga neni 187, par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën e tij hyrëse, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se aktakuza ndaj tani të akuzuarve L.K. dhe E.D. është mbështetur në prova të mjaftueshme, administrimi i të cilave do të përcaktoi gjendjen faktike, e në veçanti nga dëshmia e të dëmtuarve A.S. dhe B.B., si dhe nga dëshmia e dëshmitarit F.B.. **Ndërsa, në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim Prokurori i Shtetit ka deklaruar se** mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar ndaj të akuzuarve L.K.dhe E.D. në drejtim të veprës penale sulm nga neni 187 par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK, pasi që nga provat e siguruara në procedurën hetimore dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike se të akuzuarit kanë kryer veprën penale si më lart, e kjo gjendje është vërtetuar në bazë të dëshmisë së të dëmtuarve A.S. dhe B.B., si dhe nga dëshmia e dëshmitarit F.B., nga të cilët është vërtetuar se ditën kritike të akuzuarit L.K.dhe E.D., i kanë sulmuar të dëmtuarit me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke shtuar se nga deklarata e të dëmtuarit A., u vërtetua se ditën kritike i njëjti ka qenë i sulmuar nga L.K., e po ashtu edhe i dëmtuari B.4 e vërteton të njëjtën çështje, ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit F.B., vërtetohet se ditën kritike të akuzuarit E. dhe L. e kanë sulmuar të dëmtuarin B.4. Në fund të fjalës së saj, prokurorja i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënoi sipas ligjit.

I dëmtuari A.S., në fjalën hyrëse ka deklaruar se ndihet i dëmtuar dhe ushtron kërkesë pasurore juridike për kompensim dëmi, duke shtuar se ia lë gjykatës që ta caktoj vlerën e dëmit, e këtë e ka përsëritur edhe në fjalën e tij përfundimtare.

I dëmtuari B.S., në fjalën hyrëse ka deklaruar se ndihet i dëmtuar dhe ushtron kërkesë pasurore juridike për kompensim dëmi, duke shtuar se nuk mund ta përcaktoj vlerën e kërkesës, e këtë e ka përsëritur edhe në fjalën e tij përfundimtare.

I akuzuari L.K., në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se nuk është fajtorë dhe ka propozuar që në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohet polici A.Gj., nga Stacioni Policor në F.K., i cili nuk ka qenë kur ka ndodhur rasti por ka ardhur më vonë në stacion, propozim të cilin trupi gjykues e ka refuzuar me arsyetim se dëshmitari i propozuar nuk ka qenë i pranishëm në momentin kur ka ndodhur ngjarja. **Ndërsa, në fjalën**

përfundimtare i akuzuari L.K. ka theksuar se dëshmitë e dëshmitarëve nuk përputhen me njëra tjetrën dhe se ai ka pasur problem me tani të dëmtuarit si dhe nuk i ka sulmuar të njëjtit. Në fund të fjalës së tij, i akuzuari Krasniqi ka kërkuar nga gjykata drejtësi, pasi që ka besim të plotë në sistemin gjyqësor.

I akuzuari E.D., në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet pafajësia e tij. **Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka theksuar se** edhe unë pajtohet me fjalët e shokut të tij L.K.dhe nuk ka çka të deklaroi më tepër.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar të dëmtuarit A.S. dhe B.B.dhe dëshmitari F.B., ndërsa të akuzuarit kanë shfrytëzuar të drejtën për tu mbrojtur në heshtje, të paraqitura si në vijim:

- **Dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit A.S.**, i cili ka deklaruar se ditën kritike kur ka ndodhur ky rast, ai me B.4 dhe F.B. kanë qenë në shkollë, në ora 18:20, kanë përfunduar mësimin dhe kanë vazhduar për në Stacionin e Autobusëve në F.K. te rrethi, përkatësisht te rruga për P., duke shtuar se te parku i qytetit në F.K., ka filluar ngjarja kur në fillim të akuzuarit B.3, L. dhe E., i kanë provokuar me fjalët “çka jeni tu ba, a po doni me u rreh”, e me tani të dëmtuarit kanë qenë një grumbull nxënësish dhe se tani të akuzuarit asnjëherë para këtij rasti nuk i ka parë. I dëmtuari A. ka thënë se në fillim i akuzuari B.3 iu është drejtuar me fjalët si më lart dhe e ka sulmuar tani të dëmtuarin B.4, e pas këtij sulmi ai-A. dhe F. kanë reaguar për ta tërhequr B.4, e ku edhe ka filluar përleshja mes tyre, me ç rast i kujtohet se tani i akuzuari L. e ka goditur nëpër pjesët e trupit me grushta, e pastaj ka tentuar ta godas edhe i akuzuari B.3, por ky- i dëmtuari A. është largua, duke shtuar se nuk e di pse ka ndodhur kjo përleshje dhe se pas atij momenti me L. dhe E. nuk kanë pasur ndonjë problem. Po ashtu, i **dëmtuari-dëshmitarit A.** ka thënë se tani nuk i kujtohet se çfarë ka vepruar i akuzuari E. gjatë asaj përleshje. Në pyetje nga i akuzuari E.D., i dëmtuari – dëshmitari A.S. është përgjigjur se nuk mund të thotë se ai-E. e ka sulmuar atë ditë.
- **Dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit B.B.**, i cili ka deklaruar se kur ka ndodhur ky rast me tani të dëmtuarit A. dhe F. kanë qenë duke u kthyer nga shkolla, në parkun e shkollës kur derisa kanë qenë duke lëvizur, tani i akuzuari L. e ka thirrë për tu rrahur brenda në park, e derisa ky-B.4 nuk ka hyrë të njëjtin e ka sulmuar B.3 - shoku i L., me ç rast ai e ka sulmuar edhe F., ndërsa L. e ka sulmuar me grushta B.4, duke shtuar se kurrë nuk i ka njohur më herët tani të akuzuarit dhe se tani të akuzuarin E. nuk e ka parë në ato momente

sepse ka qenë i rrëzuar nga L., nga goditja e të cilit ka rënë në kubëzat rreth pemës dhe është lënduar në kukë. Pastaj, i **dëmtuari-dëshmitarit B.4 ka theksuar se** A. ka qenë i sulmuar nga L. dhe këtë e ka vërejtur sepse ka qenë afër tij, duke shtuar se nuk ka vërejtur persona të tjerë për rreth sepse ka qenë i lënduar dhe pasi ka përfunduar ky rast ka kuptuar se F., ka qenë i lënduar me thikë, e për të cilin ka thënë se me F. kanë shkuar në ambulancën e F.K., prej nga me automjet të kësaj ambulance janë dërguar në emergjencë në P., ku ndihmë mjekësore ka marrë F. dhe se kur e ka parë F. në atë gjendje nuk i ka rënë në mend për vete. Në pyetje të Prokurorit të shtetit, i dëmtuari B.4 është përgjigjur se nuk e ka vërejtur tani të akuzuarin E.D. duke e sulmuar dikë sepse ka qenë i lënduari i parë në këtë rast dhe ka qenë përmbys në drejtim të tokës. Ndërsa në pyetje nga ATGJ, i dëmtuari – dëshmitari **B.4 ka thënë se** tani i akuzuari L. e ka goditur në kokë - ballë në anën e djathtë nga e cila goditje ka rënë në tokë, dhe tani i akuzuari L. ka vazhduar ta godas.

- **Dëshmia e dëshmitarit F.B.**, i cili ka deklaruar se kur ka ndodhur ky rast sulmi është bërë nga i akuzuari B.I., si dhe dy të akuzuarit L. dhe E., duke shtuar se të akuzuarit L. dhe E. e kanë sulmuar të dëmtuarin B.4, i cili ka qenë i shtrirë në tokë kur e kanë sulmuar të akuzuarit. Në këtë rast, dëshmitari F. ka thënë se e ka vërejtur këtë situatë dhe ka shkuar për t'i ndarë ata, por nuk ka arritur sepse i akuzuari B.3 e ka goditur dy herë pas shpine me thikë, duke shtuar se nuk i ka njohur më herët por i ka parë të akuzuarit L. dhe E. duke e sulmuar të dëmtuarin B.4 dhe se në atë moment ka qenë 3-4 metra larg tyre, si dhe ka qenë në drejtim të tyre.

Në mbrojtjen e tij, i akuzuari L.K. ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje.

Në mbrojtjen e tij, i akuzuari E.D. ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje.

Pas vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarëve, gjykata vërtetoi se:

Në këtë rast është vërtetuar se të akuzuarit me datë me datë 05.11.2013, rreth orës 18:27, në F.K., në rrugën “N.T.”, gjegjësisht te parku i qytetit, në bashkëveprim dhe me dashje kanë përdorur forcën ndaj të dëmtuarve A.S. dhe B.B., të cilët i kanë goditur në pjesë të ndryshme të trupit.

Nga Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit A.S., është vërtetuar se ditën kritike kur ka ndodhur ky rast, ai me B.4. dhe F.B. kanë qenë në shkollë, në ora 18:20, dhe posa kanë përfunduar mësimin të akuzuarit B.3, L. dhe E., i kanë provokuar me fjalët “qka jeni tu ba, a po doni me u rreh”, e pastaj i akuzuari B.3 e ka sulmuar tani të dëmtuarin B.4, ndërsa i akuzuari L. e ka goditur të dëmtuarin A.S. nëpër pjesët e trupit me grushta.

Ndërsa, nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit B.B., është vërtetuar se kur ka ndodhur ky rast me tani të dëmtuarit A. dhe F. kanë qenë duke u kthyer nga shkolla, kur në parkun e shkollës atë-B.4 e ka sulmuar i akuzuari B.3, ndërsa i akuzuari L. e ka sulmuar me grushta të dëmtuarin B.4.. Pastaj, i **dëmtuari B.4 ka theksuar se** A. ka qenë i sulmuar nga L. dhe këtë e ka vërejtur sepse ka qenë afër tij.

Nga dëshmia e **dëshmitarit F.B.**, është vërtetuar se sulmi është bërë nga i akuzuari B.I., si dhe dy të akuzuarit L. dhe E., duke shtuar se të akuzuarit

L. dhe E. e kanë sulmuar të dëmtuarin B.4, i cili ka qenë i shtrirë në tokë kur e kanë sulmuar të akuzuarit dhe se këtë e ka vërejtur pasi ka shkuar për t'i ndarë ata, por nuk ka arritur sepse i akuzuari B.3 e ka goditur dy herë pas shpine me thikë atë-F. dhe i ka parë të akuzuarit L. dhe E. duke e sulmuar të dëmtuarin B.4 pasi në atë moment ka qenë 3-4 metra larg tyre, si dhe ka qenë në drejtim të tyre.

Sa i përket dëshmive të tani të dëmtuarve A.S. dhe B.B., si dhe dëshmitarit F.B., trupi gjykues i ka vlerësuar dhe analizuar, duke ardhur në përfundim se dëshmitë e tyre janë të besueshme dhe bindëse për gjykatën se tani të akuzuarit kanë kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e kjo është vërtetuar nga përshkrimi i rastit nga tani të dëmtuarit dhe dëshmitari, të cilët kanë përshkruar në detaje veprimet inkriminuese për të akuzuarit L. dhe E., të ndërmarra ndaj tani të dëmtuarve.

Ndërsa, gjykata nuk ka arritur të marr deklarimin e të akuzuarve për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit sepse të njëjtit kanë shfrytëzuar të drejtën për tu mbrojtur në heshtje.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që:

- ndaj të akuzuarve, gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: mosha e re e të akuzuarve në kohën e kryerjes së veprës penale; bashkëpunimi me prokurorinë dhe gjykatën; sjelljen e mirë të tani të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale dhe sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së kryerjes së veprës penale, pasi që për të njëjtin sipas evidencës së kësaj gjykate - Departamenti i Krimeve të Rënda, nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë se të akuzuarit kanë kryer ndonjë vepër tjetër penale;
- ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së tani të akuzuarve në kryerjen e veprës penale.

Andaj, gjykata të akuzuarve si më lart iu ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tyre, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e shikimit të shkresave të lëndës në shqyrtimin fillestar, kryetari i trupit gjykues ka vërejtur se lidhur me veprën penale Lëndim i lehtë trupor, në bashkëkryerje, nga neni 188, par. 1, nënpar.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK, të paraqitur në pikën II, të dispozitivit të aktakuzës, ka arritur afati absolut i parashkrimit të ndjekjes penale sepse vepra penale për të cilën janë akuzuar: B.I.; L.K.dhe E.D., është kryer me 05.11.2013.

Me qenë se vepra penale për të cilën janë akuzuar të pandehurit: B.I.; L.K.dhe E.D., në akuzë thuhet se është kryer me datë 05.11.2013, me dispozitat e KPRK, është vepër penale dhe për të cilën ky kod ka paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në një (1) vit, gjykata pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret është shkaktuar parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale nga se:

Në bazë të nenit 106, par.1 nënpar. 1.6 të KPRK, parashkrimi shkaktohet në afat prej dy (2) vite nga kryerja e veprës penale për të cilën në bazë të KPRK, të pandehurit mund t'i shqiptohet dënim gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

E në bazë të nenit 107, par.1 dhe 8, të KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast, kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, respektivisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale, e që në rastin konkret është data 05.11.2017.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, pasi që ka bërë një kërkesë të përgjithshme pa arsyetuar në mënyrë detaje kompensimin për secilën bazë dhe pa propozuar një ekspertizë përkatëse, e cila do të përcaktonte me saktësi llojet dhe vlerën e kompensimit të dëmit

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, për pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, për pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, u mor në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitivin e I, të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart e në bazë të neneve 106, par.1, nënpar. 1.6, nenit 107, par.1 dhe 8 të KPRK dhe nenit 363, par. 1, nënpar. 1.3, u vendos si në dispozitivin e II, të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 04.12.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.422/15, datë 30.11.2017.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.